

“BUKA” sha

NJOFTIM: Date 21.03.2019

THIRRJE E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË BUKA SHA

BUKA SHA është një Shoqëri Aksionare Shqiptare, me seli ne Rr. Kavajës, Tiranë, Shqipëri, e themeluar më datë 17.10.1995, thërret Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (“Asambleja”), e cila do të mbledhet në selinë e Shoqërisë BUKA SHA, Rr Kavajës (përpara Birra Tirana), më date 10 Prill 2019, në ora 10:00, sipas rendit të ditës të mëposhtëm:

Shoqëria thërret Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve e cila do të mbledhet në selinë e Shoqërisë "BUKA sh.a." Rr. Kavajës (përpara Birra Tirana), më date 10 Prill 2019, në ora 10:00, sipas rendit të ditës të mëposhtëm:

1. Miratimi I Pasqyrave Financiare per vitin fiskal 2018;
2. Caktimi i Ekspertëve Kontabël të autorizuar të Shoqërisë për vitin 2019;
3. Të tjera.

Ftohen të gjithë Aksionarët e Shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre (konform kërkesave të ligjit të aplikuar), të marrin pjesë në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, në vendin, datën dhe orën e sipër-cituar. Përfaqësimi në Asamble do të bëhet konform dispozitave të nenit 140 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Statutit të Shoqërisë.

Për cdo pyetje, sqarim, informacion të mëtejshëm, sygjërim dhe/ose kërkesë në lidhje me rendin e ditës si dhe marrjen e dokumentacionit, mënyrën e thirrjes së kësaj mbledhje Asambleje, mënyrës dhe procedurave të përfaqësimit dhe votimit konform dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionarët e Shoqërisë (i) mund të paraqiten në selinë e Shoqërisë cdo ditë (E Hënë- E Premte) nga ora 14.30-16.00; (ii) të shkruajnë në postën elektronike info@buka-sha.com; (iii) të shkruajnë nëpërmjet postës së regjistruar në adresën e Shoqërisë, duke përcaktuar qartë emrin dhe adresën e Aksionarit dërgues; apo (iv) te konsultojë faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë: www.buka-sha.com. Aksionarët apo përfaqësuesit e tyre duhet të kenë me vete një mjet identifikimi (kartë identiteti/pasaportë) dhe në rast përfaqësimi edhe prokurën e noteruar.

ADMINISTRATOR
Gezim BESHOLLI